



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
DREJTORIA E MBIKQYRJES SË TREGUT

Tiranë, më 30/04/2012

**NJOFTIM PARAPRAK PËR PËRJASHTIM NGA NDALIMI I
MARRËVESHJES**

**“MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS “INSIG” SH.A, “SIGMA VIG”
SH.A, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A, “INTERSIG VIG” SH.A,
“INTERALBANIAN VIG” SH.A, “ATLANTI” SH.A, “EUROSIG” SH.A
DHE “ALBSIG” SH.A”**

Më datë 06.04.2012, Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 49, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) ka marrë njoftimin nga ndërmarrjet “INSIG” Sh.a, “SIGMA VIG” Sh.a, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a, “INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTI” Sh.a, “EUROSIG” Sh.a dhe “ALBSIG” Sh.a”, për përjashtimin e Marrëveshjes “Marrëveshje Bashkëpunimi” të lidhur ndërmjet tyre më datë 02.04.2012.

Kjo marrëveshje është një marrëveshje standartizimi dhe ka si objekt vendosjen e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve kufitare të mjeteve motorrike (Polica Kufitare) lidhur me shkëmbimin e informacionit për eliminimin e shitjes se policave të sigurimit false, llogaritjen e dëmit, studimet e tregut dhe mbulimin e përbashkët të risqeve që rrjedhin nga mbajtësit e policës kufitare të sigurimit.

Ndërmarrjet nënshkruese të marrëveshjes ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në ofrimin e shërbimeve të sigurimit të jetës dhe jo-jetës.

Qëllimi i marrëveshjes do të jetë shkëmbimi i informacionit mes palëve në marrëveshje për mbulimin e riskut të policave kufitare të periudhës para nënshkrimit të marrëveshjes, shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primeve të sigurimi, organizimin e studimeve të përbashkëta të tregut dhe shpërndarjen e rezultateve të këtyre studimeve pa vonesë të gjitha palëve në marrëveshje.

Gjithashtu palët në marrëveshje kanë rënë dakord që gjithë informacioni i mësipërm të njoftohet në baza periodike (të paktën një mujore) në Byronë Shqipëtare të Sigurimeve.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ardhur, Autoriteti Konkurrencës konstatoi që, njoftimi i marrëveshjes për përjashtim është në përputhje me nenin 6, 48, dhe 49 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Ky njoftim do ti nënshtrohet procedurës së përjashtimit të marrëveshjeve nga ndalimi të përcaktuar në Seksionin II “Procedura për Përjashtimin e Marrëveshjeve nga Ndalimi” i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë, nga publikimi i këtij njoftimi në adresat: Autoriteti i Konkurrencës, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; fax (nr 0355 4 2234 497), e-mail në adresën competition@caa.gov.al.